



Në pajtim me nenin 18 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216 (i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 15 të Ligjit Nr: 04/L-133), Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK), më datë **23.02.2021**, publikon:

### **Konkurs për pozitën:**

Ekspert, auditor i certifikuar, anëtar jo-ekzekutiv i Bordit Menaxhues të FSDK-së me mandat pesë vjeçar.

### **Profili i kërkuar:**

- Arsimim të lartë profesional në çështje financiare, bankare apo ligjore;
- Arsimim profesional për auditor të certifikuar në përputhje me paragrafin 2, të nenit 30 të Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe auditim;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale/akademike në fushën e auditimit si dhe në çështje bankare, financiare apo ligjore;
- I/E njohur për standard të lartë të integritetit dhe reputacionit;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera paraqet përparësi;
- Pa asnjë mandat politik, aktualisht apo në vitin paraprak;
- Gjatë vitit paraprak pa histori punësimi apo angazhimi si drejtues ose anëtar i Bordit në ndonjë institucion financiar që pranon depozita në Kosovë, anëtar të FSDK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojë kriteret e përshtatshmërisë sipas nenit 20, paragrafët 1.1-1.4 të Ligjit Nr: 03/L-216 Mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë.

Përgjegjësitë si anëtar i Bordit do të përfshijnë përgjegjësitë e përcaktuara me Nenin 19 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216 (i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 16 të Ligjit Nr: 04/L-133):

- Emërimin e Drejtorit Menaxhues të FSDK-së;
- Lidhjen e kontratave dhe të jetë palë në procedura ligjore;
- Marrjen, mbajtjen dhe heqjen dorë nga prona e FSDK-së;
- Miratimin e të gjitha rregullave, urdhëresave dhe udhëzimeve për menaxhimin dhe operimin e FSDK-së;
- Miratimin e planit financiar të Fondit dhe deklaratat financiare;
- Miratimin e Politikës së Fondit për investime e FSDK-së;
- Të marrë vendime për caktimin e nivelit të premimeve ashtu siç parashihet me ligj;
- Të bëj rekomandime mbi ndryshime në Ligjin për Sigurimin e Depozitave bazuar në përvojën operacionale të aplikimit të tij;
- Miratimin e emërimit të auditorit të jashtëm të FSDK-së;
- Miratimin e metodave të pagesave nga Fondi për rimbursimin e depozitorëve në një ngjarje të siguruar apo, miratimin e shfrytëzimit të fondeve lidhur me bartjen e detyrimeve në përputhje me këtë ligj në konsultim me Bankën Qendrore;
- Vlerësimin e dënimeve dhe aplikimin e masave ndëshkuese për veprimet në kundërshtim me këtë ligj;
- Determinimin që premiumet e vazhdueshme duhet reduktuar sipas nenit 10 të këtij ligji nëse arrihet niveli i fondit;
- Miratimin e huazimeve sipas nenit 17 të ligjit bazik;
- Miratimi i numrit të stafit sipas rekomandimit nga Drejtori Menaxhues i Fondit.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë CV-në e detajuar, letrën motivuese, diplomën dhe certifikatat e tjera mbështetëse në e-mailin: [FSDKkomisioni@fsdk.org](mailto:FSDKkomisioni@fsdk.org).

Afati i fundit për aplikim është data **09.03.2021**.

Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet do të njoftohen nga Burimet Njerëzore të FSDK-së për datën e intervistës brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së konkursit.